



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 25/2 Prot

Tiranë, më 26.2.2024

**V E N D I M**

Nr.20, datë 26/2/2024

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Korçë dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 89, datë 1.11.2023 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Korçë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Korçë.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të karrierës, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1057/1 prot., datë 1.11.2023, të miratuar nga Komisioneri, i cili i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë Korçë me

shkresën nr. 1057/2 prot., datë 1.11.2023 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Korçë”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 25 prot., datë 08.01.2024 “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë”, duke i lënë afat 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Një aspekt me rëndësi i administrimit të shërbimit civil që vlen të theksohet në këtë institucion është numri i lartë i pozicioneve të lira të evidentuara, saktësisht 78 pozicione të paplotësuara, situatë kjo e konstatuar edhe më parë nga verifikimet e kryera në Bashkinë Korçë.

Nisur nga ky fakt, si dhe në kushtet kur institucioni është duke kryer procesin e miratimit të strukturës, duhet së pari, të bëhet një rivlerësim i pozicioneve të punës në shërbimin civil si në drejtim të numrit të tyre, ashtu edhe të detyrave që kryejnë, për të bërë një ndarje të qartë të pozicioneve të shërbimit civil me ato të natyrës administrative e më tej, të bëhet edhe një analizë e thelluar për nevojat objektive që ka institucioni për pozicione pune në shërbimin civil.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin, nëpërmjet shkresës nr. 8816/3 prot., datë 12.1.2024 “Kthim përgjigje” (protokolluar në KMSHC me nr.25/1, datë 22.1.2024), ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se parregullsitë e evidentuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme. Vërejtjet e pasqyruara në raportin përfundimtar, janë të karakterit parimor që nuk e cenojnë në thelb ndonjë prej proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, e ndryshuar,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil në

njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Korçë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematikat e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues. Sqarimi me burimet njerëzore e më tej ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Korçë, së bashku me një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore.

Po kështu, duhet të njoftohen nga ana e njësisë përgjegjëse për këtë vendim të gjithë punonjësit që kanë rolin e eprorit të drejtpërdrejtë, të cilët janë përgjegjës për procesin e hartimit dhe rishikimit/rivlerësimit të përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, pasi këto aspekte administrimi do të jenë në fokus në mbikëqyrjen pasuese që do të zhvillohet në këtë subjekt nga Komisioneri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**